

## **FJALA PËRSHËNDETËSE E KRYETARI TË XHAMISË, FAREDIN XHAFERI**

(KONCERTI ISLAM – 05.02.2017)

I nderuari Koordinator i Bashkësisë Islame të Maqedonisë, Dr. Selver ef. Xhemali  
I nderuari sekretar i Unionit të Imamëve Shqiptarë në Zvicër, hafiz Mehas ef. Alija  
I nderuari kryetar i DIGO-s, Mr. Bekim ef. Alimi  
Të nderuar mysafirë të veçantë nga vendlindja  
Të nderuar imamlerë, kryetar xhamish, mysafirë dhe të pranishëm

Në emër të kryesisë dhe të xhematit të xhamisë sonë “Hëna e re” në Kreuzlingen ju përshëndes me “es-selamu alejkum ve rahmetullahi ve berakatuhu” duke ju dëshiruar mirëseardhje në këtë ditë festive islame të organizuar nga xhamia jonë me mbështetjen e fuqishme të dy forumeve të xhamisë, pra: të Forumit të Rinjve Muslimanë dhe Forumit të Grave Muslimane.

Pjesëmarrja kaq e madhe në numër e juaja për ne dhe për mysafirët tanë specialë është një nder i veçantë, për çka ju falënderojmë përzemërsisht. Prania juaj këtë manifestim e bën edhe më madhështor.

Për realizimin më të lehtë të kësaj mbrëmjeje, sidomos nga aspekti material, ne kemi pasur nevojë për mbështetjen e firmave të bashkëkombësve tanë që veprojnë këtu në Zvicër. Andaj, ne shprehim një falënderim të madh ndaj të gjithëve, por në veçanti ndaj sponsorëve tanë të cilët gjithmonë na kanë mbështetur në raste të këtilla.

Ngelim me shpresën të kaloni çaste të këndshme familjare.

Ves-selamu alejkum ve rahmetullah!